



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.05.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës: Prezantimi nga ana e Ekspertëve Ndërkombëtarë pranë Komisionit, z. Rainer Deville (EURALIUS-BE) dhe z. Jon Smibert (OPDAT-SHBA), i Projektit Kushtetues me reflektimet e Opinionit Final të Komisionit të Venecias dhe komentet e propozimet e bëra nga anëtarët e Komisionit në mbledhjet e mëparshme.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Fatmir Mediu, Gent Strazimiri, Oerd Bylykbashi, Arben Ristani.

Mungon: Spartak Braho

Të ftuar:

Donald Lu - Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri

Romana Vlahutin - Ambasadore, Delegacioni i BE-së në Shqipëri

Rainer Deville - Shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert - Përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje të gjithëve!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Jemi të gjithë të pranishëm. Para se të fillojmë me procedurën normale të punës, siç kemi vendosur edhe në mbledhjet e mëparshme, dëshiroj të bëj të ditur faktin se të pranishëm në këtë mbledhje kemi Ambasadorin e Bashkimit Europian, zonjën Romana Vlahutin dhe Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara, zotin Donald Lu, të cilët në një rast të paprecedent të komisioneve parlamentare, por shumë të justifikuar, për mënyrën se si është ndërtuar i gjithë ky proces, janë kontributorë aktivë përmes ekspertizës dhe asistencës së tyre gjatë gjithë këtij procesi, edhe në produktin e reformës, për shkak të vëmendjes së jashtëzakonshme që dy partnerët tanë kryesorë i kanë kushtuar kryerjes së reformës në drejtësi. Ata janë sot këtu me kërkesën dhe me dëshirën për t'iu adresuar këtij komisioni. Besoj se shpreh dhe vlerësimin e përbashkët të të gjithë kolegëve anëtarë të komisionit dhe në emrin tuaj dëshiroj t'i falënderoj për prezencën e tyre në këtë komision.

Fillimisht po ia jap fjalën Ambasadores Vlahutin.

Romana Vlahutin - Mirëdita zoti Xhafaj, zoti Halimi, anëtarë të nderuar të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, ekspertë të dashur, i nderuar Ambasador Lu.

Së pari, ju falënderoj të gjithëve për punën dhe angazhimin në këtë proces. Në veçanti, dua të falënderoj ekspertët për kujdesin dhe përkushtimin e treguar që ka shkuar përtej përshkrimit të projektit. Tashmë ndodhemi në fazën e fundit të procesit, përcaktimin e detajeve dhe miratimin në Parlament, sa më shpejt që të jetë e mundur. Ka pasur shumë pengesa gjatë procesit, kryesisht politike, shumë keqkuptime, mungesë komunikimi dhe mbi të gjitha mungesë besimi. Tashmë kjo është pas nesh, dhe gjej guximin për të thënë se nuk janë më të rëndësishme. Ajo çfarë është e rëndësishme është e ardhmja e Shqipërisë.

Më lejoni t'iu them, çfarë sjell kjo reformë për shtetin tuaj nga këndvështrimi i Bashkimit Europian. Para së gjithash, nëse zbatohet mirë, sjell standarde europiane në sistemin e drejtësisë për shtetasit e Shqipërisë dhe një sistem drejtësie funksional që nuk do të varet nga politikat e përditshme, sjell një sistem të pastër për ata të cilët e abuzuan, përfituan, ata që mbrojtën dhe toleruan krimin, në vend që ta ndëshkonin, sjell një sistem

të aftë dhe të gatshëm për të hetuar dhe ndjekur penalisht të gjithë ata që guxojnë të abuzojnë me paratë dhe besimin e publikut. Më lejoni të përsëris çfarë keni dëgjuar tashmë nga zv.Presidentja e Komisionit European, znj. Mogherini, dhe Komisioneri Hahn. Miratimi i reformës para verës dhe fillimi i zbatimit në vjeshtë do të hap mundësinë që Shqipëria të marrë një rekomandim pozitiv nga Komisioni për hapjen e bisedimeve. Nuk është nevoja t'iu shpjegoj se çfarë do të thotë kjo për vendin tuaj. Do të jeni në gjendje që të ecni me hapat e shteteve e tjera të cilët janë duke negociuar, gjë që do të ndryshonte këndvështrimin e rajonit përgjithmonë, për më mirë.

Me këtë reformë ju do të kaloni kapitujt 23 dhe 24, duke përmbushur disa nga pjesët më të vështira të negociimeve. Për herë të parë në historinë moderne, Shqipëria do të jetë duke vepruar me hapin e kohës. Gjithashtu do të jetë një sinjal pozitiv, i shumëkërkuar nga investitorët privatë dhe bizneset, që Shqipëria është një vend i sigurt për kapitalin dhe gatishmërinë për zhvillim. Nëse ky moment për Shqipërinë humbet, nuk do të jetë vetëm një vit i humbur por shumë. Është e rëndësishme për ju dhe shtetasit shqiptarë të kuptojnë se çfarë është në rrezik. Ne besojmë se Shqipëria nuk mund të humbasë me kohë. Bashkimi European dhe Shtetet e Bashkuara janë këtu, ne të gjithë jemi këtu pasi përkujdesemi. Ne nuk do të lejojmë politikat ditore të dëmtojnë qëllimin strategjik, në asistimin për Shqipërinë, për të pasur një demokraci të begatë, plotësisht funksionale dhe të qëndrueshme. Është në interesin tuaj si dhe në interesin tonë. Nuk ka asgjë tjetër për të thënë. Mendoj që është shumë e thjeshtë. Tashmë ju keni përgjegjësi personale dhe politike para vendit dhe popullit tuaj. Shtetasit të cilët ju kanë votuar kanë thënë qartazi se duan dhe kërkojnë një sistem drejtësie të riformuar. Tani, të gjithë janë duke ju vëzhguar se çfarë jeni duke bërë, shtetasit tuaj, mediat, komuniteti ndërkombëtar, biznesi. Nuk e ekzagjeroj kur them se kjo është një mundësi unike për Shqipërinë. Ju lutem mos e humbisni këtë mundësi. Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka ambasadori i Shteteve të Bashkuara, zoti Donald Lu.

Donald Lu – Anëtarë të komisionit, kam një mesazh për ju. Nëse kjo reformë dështon, ju, anëtarët e këtij komisioni, do të turpëroni njerëzit që ju kanë zgjedhur. Do të turpëroni marrëdhënien tuaj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin European. Fatmirësisht ne së bashku nuk do ta lejojmë të dështojë kjo reformë. Vendi po

shpreson që ju ta realizoni këtë reformë me sukses dhe ne do t'ju ndihmojmë ta bëni këtë gjë. Dr. Smibert dhe Dr. Deville janë njerëzit më të mirë në profesionin e tyre në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata së bashku me kontributin tuaj dhe nën drejtimin e opinionit përfundimtar të Komisionit të Venecias, kanë përgatitur këtë draft përfundimtar të projektit të reformës në drejtësi. Jam krenar të them se e mbështes atë edhe pse nuk e kam manipuluar përmbajtjen e tij dhe as nuk më kanë dhënë ndonjë kopje përpara. Di, gjithashtu, që askush nga ju nuk ka pasur mundësinë ta lexoj atë.

E mbështes atë sepse besoj në integritetin, njohurinë, paanshmërinë politike të këtyre dy ekspertëve ndërkombëtarë. Unë besoj në aftësitë dhe në dëshirën e tyre të sinqertë që Shqipëria të ketë sistemin gjyqësor më të mirë të mundshëm. Ju bëj thirrje që ta studioni këtë dokument, të ngrini pyetje dhe të diskutoni mbi atë që do të gjeni këtu që t'i shërbejë më mirë popullit shqiptar. Në fund të ditës ju kërkoj të gjithëve të votoni pro reformës në drejtësi.

Gjatë vitit të shkuar kam parë zonjën Merkel, zonjën Mogherini, zotin Hahn, zotin Kerry dhe zotin Obama t'i kërkojnë Shqipërisë ta miratojë këtë reformë. Nuk kam parë kurrë mbështetje të tillë nga aleatët tuaj më të afërt për asnjë temë tjetër. Të gjithë e pranojmë se sa e rëndësishme është kjo për të ardhmen e Shqipërisë. Por më shumë se kaq, ju dhe unë e dimë se populli shqiptar, të pasur dhe të varfër, të rinj dhe të moshuar, banorë të fshatit dhe të qytetit, burra dhe gra, e kërkojnë këtë reformë. Janë 91% që e mbështesin këtë reformë. Mendojeni pak këtë gjë. Shqiptarët nuk bien dakord për shumë gjëra e megjithatë 91% mund të bien dakord se vendi ka nevojë për këtë reformë. E mëshiroj partinë e verbër politike apo udhëheqësin e shurdhët politik që e bllokoi këtë reformë.

E para, do të dështoni nëse kërkon ta bllokoni këtë reformë.

E dyta, do të përballeni me zemërimin e publikut shqiptar vitin e ardhshëm në zgjedhjet parlamentare nëse mendoni se mund të mbron gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar, duke e bllokuar këtë reformë.

Së fundmi, i kërkoj komisionit sot të mbështesë një kalendar të vërtetë për miratimin e kësaj reforme, në këtë komision deri në fund të majit dhe në parlament të deri në fund të qershorit. Ndalojini lojërat politike dhe filloni ta përfundoni këtë reformë. E keni për detyrë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti ambasador!

Faleminderit, zonja Vlahutin!

Faleminderit, zoti Lu, që ishit të pranishëm, por edhe për adresimin tuaj ndaj këtij Komisioni, ndaj Kuvendit të Shqipërisë dhe opinionit publik. Ne e vlerësojmë shumë faktin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian, si partnerët strategjikë të Shqipërisë, janë mbështetësit kryesorë të gjithë këtij procesi, kemi marrë mbështetje përmes inkurajimit moral, asistencës konkrete financiare dhe teknike, që janë angazhuar gjerësisht në këtë proces. Ky është një proces që ka marrë kohën e nevojshme, është një proces që është ndërtuar për një kohë relativisht të gjatë, por e domosdoshme për të pasur një projekt të qëndrueshëm, cilësor e me efekte sot dhe në vitet që vijnë.

Unë besoj dhe shpresoj që mbështetja juaj do të vazhdojë të jetë përsëri aktive në këtë proces, ashtu siç shpresoj dhe besoj fort që ky Komision do të miratojë së shpejti këtë projekt kushtetues dhe gjithë paketën e ligjeve që shoqëron projektin kushtetues e më pas Kuvendi i Republikës së Shqipërisë do t'i japë mbështetjen e duhur me votë konsensuale këtij procesi, sepse kjo nuk është një reformë as për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as për Bashkimin Europian. Kjo është një reformë për qytetarët shqiptarë dhe këta qytetarë e meritojnë që të kenë një sistem drejtësie të paanshëm, të lirë dhe të barabartë.

Gjithsesi, e mbyllim këtë pjesë të parë të procesit dhe vazhdojmë me pjesën normale, për t'u dhënë fjalën dy ekspertëve që do të paraqesin projektin e tyre, zotërinjve të nderuar, zoti Deville dhe zoti Smibert.

Siç kemi rënë dakord që në nisje të kësaj faze të procesit të diskutimit të projektit dhe reflektimit në të të opinionit final të Komisionit të Venecias, në vazhdim të një debati të gjerë që kemi bërë këtu në Komision përmes komenteve, pyetjeve që kemi bërë për çështje të caktuara rreth rekomandimeve të ngritura nga opinionit final i Komisionit të Venecias, por edhe mbi aspekte të caktuara të draftit kushtetues, është momenti që të dëgjojmë paraqitjen nga ana e dy ekspertëve ndërkombëtarë, shefit të misionit të Euralius-it dhe të OPDAT-it lidhur me reflektimet që ata kanë bërë mbi projektin kushtetues, bazuar në opinionin final të Komisionit të Venecias, bazuar në pyetjet dhe komentet e ngritura gjatë debatit në këtë Komision. Kjo ka qenë një detyrë që

u është dhënë nga ne në vijim të faktit që kemi pranuar që rolin e ekspertit pranë këtij komisioni ta bëjnë dy misionet e asistencës ndërkombëtare, si pjesë e një marrëveshjeje të realizuar midis nesh dhe si kusht për të garantuar më shumë besueshmëri dhe paaanësi, por, gjithashtu, edhe standarde ndërkombëtare në këtë moment final të procesit.

Besoj se do të procedojmë në një mënyrë të caktuar që mund të jetë edhe e përshtatshme për ne. Siç u tha këtu, nuk e kemi draftin. Të jemi korrektë, unë do të kisha parapëlqyer që ta kishim draftin më parë, por ndoshta edhe koha nuk ka qenë e mjaftueshme, por gjithsesi le të fillojmë sot me paraqitjen e projektit dhe, pasi të dëgjojmë paraqitjen e projektit, besoj se do të kemi një seancë të posaçme për pyetje dhe komente dhe për votimin e projektit.

Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – (nuk ka audio)

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Halimi, për procedurë.

Eduard Halimi – Unë do të doja t'i falënderoja ambasadorët për prezencën. Sigurisht këtë gjë do ta them edhe në fund të takimit para mediave, së bashku me konsideratat që do të dalin gjatë kësaj mbledhjeje.

Për procedurë, do të shpreh edhe atë që i kam thënë ekspertëve, Jon, të cilin e kam takuar javën e kaluar. Marrëveshja politike, e zhvilluar më 18 mars, parashikonte që drafti i rishikuar i amendamenteve kushtetuese nën dritën e opinionëve të Venecias, duhet të hartohet së bashku me ekspertët e secilës palë politike. Kjo është e vërteta, t'i themi gjërat ashtu siç janë. Sigurisht, kjo ishte edhe konsiderata e zotit Xhafaj, që duhej ta kishim marrë më përpara, në mënyrë që kolegët dhe unë të njiheshim dhe ta studionim me hollësi të gjithë implementimin e opinionit të Komisionit të Venecias dhe dallimet e draftit të shtatorit me atë të dhjetorit apo të janarit, kur ishte drafti i dytë që u bë. Sigurisht, tani do ta dëgjojmë, jemi në proces për ta dëgjuar dhe për ta shpalosur. Është mirë, edhe e detyrueshme që draftin të na e dërgoni në mënyrë elektronike, që ne t'ua përcjellim ekspertëve tanë dhe pastaj të procedojmë me pyetjet dhe me diskutimet në parim me një procedurë normale dhe racionale si në të gjitha rastet e tjera. Jam dakord me këtë që thotë ambasadori Lu, se duhet të caktojmë një kalendar për përgatitjen e pyetjeve, për diskutimin dhe miratimin në parim.

Dua të ripërsëris qëndrimin e opozitës për komponentin antikorrupsion, i cili përfshin pjesën e Byrosë Kombëtare të Hetimit, pjesën e Prokurorisë Speciale, pjesën e kontrollit, pra të skanimit, të vetting-ut të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Opozita prej disa muajsh është shprehur dakord në parim që këto, së bashku me ligjet, të cilat duhet të kalojnë në mënyrë vertikale, që ne i kemi shprehur, madje edhe në diskutimet politike që kemi pasur në mbledhjet e fundit, duhet të shihen edhe nga ekspertët për të na e lehtësuar punën e diskutimit këtu në komision, pra për të hequr çështjet teknike, që të mos përplaseshin të gjithë këtu, pastaj ta kalonim.

Kisha edhe diçka të fundit për procesin në emër të opozitës: sigurisht, nëse e keni në konsideratë, nëse para një viti procesi do të ishte zhvilluar me konsensus, pra do të kishte një draft të përbashkët dhe jo ndonjë draft të njëanshëm, ashtu siç u punua edhe me ligjin “Për dekriminalizimin”, ku për një draft të përbashkët u punua me ekspertët politikë të të gjitha palëve politike, nuk do të ishim vonuar një vit, pra nuk do të kishim pritur të vinte vendimi i Komisionit të Venecias, edhe sikur ekspertët të mos i qëndronin sërish shumë fanatikë versionit të tyre në dhjetor, ne do të kishim miratuar në janar një draft të përbashkët, i cili do t’i përfshinte të gjithë komponentët.

Në lidhje me komponentin tjetër, që ka të bëjë me institucionet e reja, do të shohim nëse ka ndryshime drafti i parë i shtatorit, nga drafti i dytë i janarit për të dhënë konsiderata, apo nëse ka nevojë për një studim krejt normal dhe logjik. Unë besoj se 91% e shqiptarëve e kërkojnë reformën në drejtësi, dhe kjo ka të bëjë me komponentin antikorrupsion, me luftën ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe me luftën ndaj korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë, të cilat bëhen efektive dhe japin impakt konkret, të menjëhershëm me miratimin e kësaj pakete, sapo kjo të bëhet e mundur me ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit, me kalimin dhe skanimin e të gjithë gjyqtarëve, në mënyrë që gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar dhe që nuk justifikojnë as nga ana profesionale dhe as nga ana financiare qëndrimin në detyrë, duhet të largohen një orë e më parë.

Për këtë ka konsensus dhe aq kohë sa ka konsensus për këtë proces në parim, pasi të shihen edhe çështjet e tjera, qëndrimi i opozitës, i ripërsëritur edhe sot pas gjithë kësaj kohe, pra gjatë të gjithë këtyre muajve, është që të kalojë një orë e më parë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Halimi!

Nuk besoj se do të ketë dikush tjetër diçka për procedurë.

Pandeli Majko – Kam diçka vetëm për një merak procedural. Mendoj se ashtu siç është vënë edhe në shënimin e paraqitur në draft, nuk bëhet fjalë për një draft të ri, që sot po na paraqitet për herë të parë dhe që ne duhet të kërkojmë kohë të jashtëzakonshme për të bërë ndonjë reflektim të rëndësishëm, pasi në shënimin në krye të draftit thuhet qartazi se Euralius-i dhe OPDAT-i, bazohen në propozimet që na kanë sjellë sot këtu, në varësi të përmbushjes së opinioneve të Komisionit të Venecias dhe të vendimeve politike që kemi ndërmarrë ne në të gjitha diskutimet që kemi bërë. Dua ta nënvizoj këtë fakt, sepse për procedurë do të bëj propozimin e mëposhtëm, por para kësaj dua të rithem se nuk ka nevojë që ne tani ta shikojmë këtë si një rinisje nga e para e diskutimit apo e bërjes së pyetjeve.

Ne kemi një diskutim të gjatë, i cili është reflektim në këtë dokument të paraqitur nga ekspertët, ndaj për procedurë do t'u propozoj kolegëve edhe në vazhdim të asaj që thanë dy ambasadorët e nderuar, edhe në vazhdim normal të diskutimeve që kemi pasur, që sot ta votojmë në parim këtë dokument.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, ta mbyllim.

Dakord, në princip, për procedurë.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar,

Të nderuar ambasadorë, pa i shtuar asgjë asaj që tha zoti Halimi, në lidhje me pozicionimin e opozitës në lidhje me këtë proces kaq të rëndësishëm, besoj se të gjithë e ndajmë se është e një rëndësie themelore miratimi i reformës në drejtësi. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të të gjithë asaj që kemi përpara, do të shohim se cila do të jetë ajo që do të përbëjë reformën në drejtësi. Unë besoj, gjithashtu, se është në nderin e këtij parlamenti që t'i japim Shqipërisë një reformë në drejtësi, ndryshime kushtetuese dhe ligjore bashkë, të atilla që do të na bëjnë ne ta mbajmë kokën lart tani dhe në të ardhmen.

Duke pasur edhe sensin e fortë të autorësisë sonë në 20 vjet, reforma përfshirë edhe kushtetuesen, ka qenë një emërues i përbashkët i të gjitha reformave përpjekja që ne ta kuptojmë se kjo është një Kushtetutë e jona për 10-15-20-30 vjetët e ardhshëm, ku askush prej nesh nuk do të detyrohet të rikthehet mbrapsht.

Kështu që besoj se do të kemi të gjithë hapësirën dhe kohën, zoti Majko, që, pas prezantimit që do të na bëhet ne të kemi mundësinë që të shohim me kujdes, pa nxituar në asnjë aspekt përpara se sa të arrijmë në votimin në parim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbyllim këtu pjesën procedurale me shpresën që konstruktiviteti i deritanishëm të vazhdojë deri në përmbyllje, pasi të kemi dëgjuar prezantimin dhe më pas të shohim se cili do të jetë reagimi apo hapi tjetër që do të duhet të ndërmarrim.

Fillojmë me atë që është qëllimi kryesor për të cilin jemi këtu: të dëgjojmë dy ekspertët e nderuar, shumë të vlerësuar dhe të gjithëpranuar prej nesh për vlerat, rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm që kanë luajtur dhe janë duke luajtur në këtë fazë delikate të procesit. Pra, le të mos vonohemi, ia japim fjalën zotit Smibert dhe zotit Deville për të bërë prezantimin dhe më pas ne do të bëjmë reagimet tona respektive.

Fjala për zotin Smibert apo ju zoti Deville?

Jon Smibert – Të nderuar anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, z.Kryetar, ambasadore Vlahutin, ambasador Lu, në disa nga takimet e Komisionit të Posaçëm Parlamentar unë dhe z. Deville kemi qenë të ngarkuar me disa detyra. U jemi përgjigjur një sërë pyetjesh të Komisionit, dhe po ashtu na u kërkua draftimi i Kushtetutës duke inkorporuar të gjitha sugjerimet e opinionit të fundit të Komisionit të Venecias. Ka pasur debate të shumta gjatë Komisionit të Posaçëm Parlamentar, mbi çështje të caktuara, shpesh shqetësime të ardhura nga opozita. Na u kërkua të konsultoheshim me përfaqësuesit e opozitës dhe ekspertët e nivelit të lartë, dhe e kemi bërë këtë. Opozita na dërgoi komentet e tyre dhe ne i kemi shqyrtuar të gjitha. Dr. Deville dhe unë i jemi përkushtuar seriozisht kësaj detyre. Tashmë ju prezantojmë me një dokument i cili ofron dy gjëra. Së pari, përfshin opinionin e ardhur nga Komisioni i Venecias duke e ndryshuar dhe harmonizuar atë në përputhje me shqetësimet dhe ofron disa opsione të mundshme për debatet politike që keni pasur. Në versionin shqip që ju është dhënë, ndryshimet në bazë të opinionit të Komisionit të Venecias janë shënuar me ngjyrë të kuqe, dhe me ngjyrë blu ndryshimet e bëra që reflektojnë opsionet e mundshme të cilat kanë dalë nga debatet politike.

Së pari, do doja të flisja për opinionin e Komisionit të Venecias. Në paragrafin tetë të opinionit final, Komisioni i Venecias ka theksuar që propozimet ishin në përgjithësi të arsyeshme, dhe se mbeten vetëm çështje teknike, të cilat mund të zgjidhen. Ne i kemi bërë ndryshimet për të zgjidhur çështjet teknike. Aty ku kemi bërë ndryshime, kemi cituar dhe paragrafin e Komisionit të Venecias. Disa nga ndryshimet janë harmonizime, kështu që mund të ketë përsëritje përgjatë tekstit dhe tek shënimet. Komisioni i Venecias vendosi mos të zgjidhi një nga çështjet kryesore, çështjen e mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. U konsiderua vendim politik dhe u la në dorën tuaj. Ne nuk kemi përfshirë gjë në lidhje me këtë çështje pasi mbetet akoma një vendim politik që duhet ta merrni ju. Ka disa ndryshime që janë bërë në lidhje me diskutimet politike. Kemi marrë në konsideratë komentet dhe debatet që janë bërë dhe kemi bërë disa ndryshime me synimin për të arritur standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

E para, ka të bëjë me modifikimin e Këshillit të Lartë të Emërimeve pasi ka disa shqetësime të lidhura me dy faktorë. E para, ka ekzistuar ideja se duke qenë për një periudhë tranzicioni, mund të çonte në një kontroll politik. E dyta, ndërkohë që ka ekzistuar dhe ideja që të ketë një rol këshillues, opozita nuk e donte si një mekanizëm zhblllokues apo një organ vendimmarrës. Gjatë debateve të zhvilluara, vumë re se të dyja palët mund të pranonin një proces përzgjedhjeje për anëtarët e këtij Këshilli dhe për të qenë një trupë ekspertësh, siç e ka përmendur dhe Komisioni i Venecias në nenin 149/ç sugjeruam që organi të zgjidhet çdo vit, me short, nga organet më të larta në gjykata dhe zyrat e prokurorisë. Kjo mund të krijojë një rastësi që bën të mundur përzgjedhjen e personave me eksperiencë të mjaftueshme duke reduktuar korporativizmin. Megjithatë, pa një mekanizëm të mundshëm zhblllokues nuk mund të heqim rolin e Këshillit për të rankuar kandidatët.

Tribunali Disiplinor ishte çështja e dytë ku janë ngritur shqetësime. Gjatë diskutimeve, opozita pranoi që mund të ketë një rol por prapë ishin të shqetësuar për faktin që mund t'i japë shumë pushtet një grupi të vogël gjyqtarësh. Tribunali Disiplinor, ju rikujtoj është i pranishëm vetëm për të siguruar një vend neutral për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore nga anëtarët e të dy Këshillave, Prokurorit të Përgjithshëm dhe

Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë. Komisioni i Venecias theksoi se duhet të përbëhet nga magistratë në mënyrë që të ketë cilësitë e gjykatës në përputhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Edhe këtu vendosëm përzgjedhjen me short. Kryetari i Gjykatës drejton Tribunalin. Përzgjedhja e rastësishme e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rishikimi i këtyre shkeljeve disiplinore e largon shqetësimin që një grup i vogël gjyqtarësh do të kontrollojnë këtë proces disiplinor dhe më vonë po ashtu kontroll të gjyqësorit.

Përzgjedhja e rastësishme mund të zbatohet për çdo rast dhe në këtë mënyrë anëtarët janë njësoj si anëtarët e barabartë të një jurie. Ky proces do të shtjellohet dhe më tej në ligj. Kur shqyrtoam komentet e opozitës, ata kishin disa këndvështrime. Në Komision, dukej se favorizohej përzgjedhja e rastësishme. Në komentat, ata favorizojnë që roli i Tribunalit Disiplinor t'i kalojë Gjykatës së Lartë. Për ne, kjo duket se mund të krijojë më shumë korporatizëm dhe konflikt interesi. Ne gjetëm një zgjidhje më të denjë për zhvillim.

E fundit nga shqetësimet, e ngritura gjatë diskutimeve dhe pyetjeve lidhet me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, një shqetësim më i gjerë për korporatizëm, konfliktin e interesit. Në mënyrë të veçantë, opozita diskutoi mundësinë e një Komisioni Parlamentar që mund të hetojë Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, në këtë mënyrë të thejë ciklin. Ne nuk u pajtuam që vënia nën akuzë do të ishte mjeti më i përshtatshëm për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, pasi sjell kontroll politik ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ne ishim simpatizantë të idesë që mund të përdorej Komisioni Hetimor Parlamentar. Disa argumentuan se kjo mund të rezultojë në një proces gjykimi, i cili nuk do të ishte hetim i plotë. Çfarëdo metode që do përdoret, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë duhet të ketë çështjet disiplinore që dëgohen nga gjykata, e cila në këtë rast do të ishte Tribunali Disiplinor. Ne sugjeruam se ndoshta një deputet, me diplomë drejtësie, i përzgjedhur me short, me garancinë e të drejtës për gjykim mund të jetë një metodë ku ky hetim mund të jetë më profesional dhe ende mund të mbetet i kufizuar brenda një organi tjetër përveç gjykatës. Rezultatet e këtij hetimi më pas do të dërgohen në Tribunal për gjykim.

Duke shkuar përtej këtyre tre fushave, po ashtu bëmë një sugjerim për procesin e vetting-ut, për të cilën do flasë kolegu im.

Në lidhje me ndryshimet që duheshin bërë sipas sugjerimeve të opinionit të Komisionit të Venecias, bëmë rregullime të vogla teknike në 25 nene dhe i harmonizuam ato në mënyrë që Kushtetuta të ishte e kuptueshme. Shumë prej këtyre ndërhyrjeve mendoj se duhen diskutuar. Në nenin 135 dhe 138 përcaktohet roli i gjykatës për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe zyra e prokurorisë. Na ishte kërkuar nga Komisioni i Venecias për t'i shpjeguar më qartë ato dhe ashtu vepruam. Në nenin 135 përcaktuam juridiksionin. Juridiksioni përfshinte zyrtarë të nivelit të lartë. Komisioni i Venecias na kërkoi t'i përcaktonim këta zyrtarë dhe ne e bëmë këtë. Struktura e kësaj zyre dhe gjykate ishte për të pasur një grup të pavarur, me qëllim monitorimin dhe hetimin, ndekjen penale të rasteve të korrupsionit, të krimit të organizuar, zyrtarëve të nivelit të lartë, njerëzit me influencë që mund t'i shpëtojnë drejtësisë. Kur përcaktuam zyrtarët e nivelit të lartë, përfshimë Presidentët, Kryetarët e Kuvendit, Kryeministra të mëparshëm dhe të tanishëm. Po ashtu përfshimë Këshillin e Ministrave të tre viteve të fundit, deputetë të Kuvendit, Prokurorin e Përgjithshëm, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe një sërë personash të tjerë, të cilët mund t'i lexoni në draft. Ka dhe një dispozitë që përfshin titullarë të institucioneve të pavarura, që nuk u pa e përshtatshme të përmenden në Kushtetutë. Lista nuk duhet të jetë aq e gjerë sa të mbingarkojë këtë organ, por gjithashtu duhet të jetë në gjendje të përcaktojë juridiksionin dhe substancën për rastet e anti-korrupsionit dhe krimit të organizuar të zyrtarëve të nivelit të lartë, në mënyrë që Shqipëria të fillojë të bëjë ndryshimet dhe të sigurojë drejtësinë në mënyrë që të arrijë qëllimet për pranimin në BE.

Neni 148, parashikon zgjedhjen e Kryeprokurorit të Posaçëm nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shumicë të cilësuar apo heqjen e shumicës së cilësuar. Po ashtu qartësuam raportin midis Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, SPAK dhe Prokurorit të Përgjithshëm siç ishte kërkuar nga Komisioni i Venecias.

Së fundmi, dua të theksoj se kemi bërë disa ndryshime në dispozitat kalimtare. E theksoj se në qoftë se bëhen ndryshimet në pjesë të tjera të Kushtetutës, ky nen do të duhej të rishikohej me kujdes për të shmangur problemet dhe boshllëqet që mund të krijohen.

Dua të falënderoj për punën e bërë z. Deville dhe stafin që ka punuar shumë fundjava radhazi. Ka qenë një përpjekje e gjatë, e bërë me kënaqësi për të ardhmen e Shqipërisë. Ju faleminderit!

Rainer Deville – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, të dashur ambasadorë, ekspertët shqiptarë dhe ndërkombëtarë sugjeruan ndryshimet kushtetuese për një reformë substanciale të gjyqësorit dhe Komisioni i Venecias e ka miratuar këtë projekt me komentet tona. Kur kemi filluar disa kohë më parë, detyra jonë fillestare ishte që të zhvillonim një proces teknik me një numër të madh ekspertësh. Herën e fundit, roli ynë ndryshoi pak dhe kemi bërë rolin e ndërmjetësit, për t'i dhënë një shans identifikimit të mundësive politike dhe përfaqësuesit e opozitës ndanë mendimin e tyre për këtë draft dhe sot ne prezantojmë një rezultat i cili është ky draft. Përfshin vërejtje teknike siç e shihni në *footnote*, por gjithashtu shkon përtej ushtrimit dhe tekstit shkencor, ku ne gjithashtu u përpoqëm të përfshijmë disa propozime me interes politik dhe u përpoqëm të ofronim një lloj baze për konsensus dhe për procesin tuaj të vendimmarrjes.

Çfarë ngelet për të diskutuar, veçanërisht dua të fokusohem në tre pyetje. Ju i keni bërë pyetje vetes për gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative në shkallë të fundit dhe po ashtu pyetët veten a mund të ketë Shqipëria një Gjykatë të Lartë duke pasur një kolegji për çështjet administrative, dhe nga këndvështrimi teknik dhe evropian sigurisht që është e mundur. Neni 135, paragrafi 1 ende përfshin propozimin fillestar nga ekspertët për të ngritur një Gjykatë të Lartë Administrative dhe politika duhet të zgjedhë cilin model. Ne nuk kemi ndryshuar gjë në këtë pikë, Gjykata e Lartë Administrative shfaqet në disa nene dhe do të ketë ndikim në zbatimin e ligjit. Na duhet një vendim politik dhe mendoj se duhet të vendosni në lidhje me këtë para se të mund të reflektohet në projekt.

Çështja tjetër lidhet me rolin e Ministrit të Drejtësisë. Kemi diskutuar nevojën e një autoriteti mbi dy Këshillat, në veçanti në lidhje me vendimet për çështje kompjuterike dhe nga ana teknike kemi nevojë për një mjedis kompjuterik, në mënyrë që të dhënat e ardhura nga Prokuroria të përdoren në gjykata, prokurori dhe në sistemin e provës dhe ky është edhe vizioni i *e-justice*, që përbën bazën e standardeve të unifikuara teknike. Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese se sa mund të ndërhyjë Ministri i Drejtësisë në

administrimin e drejtësisë dhe kjo duhet të rregullohet në Kushtetutë. Kjo është në nenin 147 dhe e evidentuar në *footnote 27*.

Një pyetje e ngjashme është nëse të gjitha institucionet duhet të paraqesin propozime për buxhetin e tyre dhe më pas Ministria e Drejtësisë do të negociojë me Ministrinë e Financave. Edhe ky është një vendim politik.

Elementi kyç i reformës është nevoja për të rivendosur zbatimin e ligjit dhe pavarësinë e vërtetë të sistemit gjyqësor si edhe për të fituar përsëri besimin e shtetasve në institucione. Partitë politike ranë dakord që të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në sistem do t'i nënshtrohen procedurës së vetting-ut.

Së fundmi, kam parë që një prokuror dhe një gjyqtar janë akuzuar për korrupsion dhe kjo konfirmon nevojën për një proces kontrolli të tillë. Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve duke filluar nga këshilltarët ligjorë deri tek Gjykata Kushtetuese dhe Prokurori i Përgjithshëm do t'i nënshtrohen kësaj procedure pa përjashtim. Komisioni i Venecias konfirmoi dhe miratoi nevojën për të bërë këtë.

Duke qenë modeli i parë i këtij lloji, ishte normale të përfshinim disa përmirësime teknike. Ne e kemi ndryshuar atë në bazë të propozimeve të Komisionit të Venecias dhe vetting-u do të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, në një kohë më të shkurtër. Në të njëjtën kohë, procesi do të garantojë zbatimin e ligjit, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, një proces të drejtë, të drejtën e ankimit dhe një kontroll kushtetues. Është sfidë kombinimi i të gjithë këtyre parimeve dhe prandaj propozojmë ndryshime në lidhje me sqarimet e propozuara dhe tashmë kemi një kohëzgjatje të shkurtër dhe në mënyrë që ta bëjmë të mundur, rritëm numrin e Komisionerëve të shkallës së parë, i dyfishuam që të kemi kapacitetin e duhur dhe vendosën Apelin në Gjykatën Kushtetuese dhe kjo është e vetmja mënyrë për të garantuar kontroll kushtetues edhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

I gjithë procesi i vlerësimit do të monitorohet nga ndërkombëtarët, nga fillimi deri në fund, dhe këtë mund ta gjeni në nenin B të Aneksit. Komisioni Evropian ka komentuar mbi këtë draft dhe në mënyrë të veçantë do doja të falënderoja znj. Vlahutin, e cila u angazhua personalisht në Bruksel për të bërë të mundur këtë skenar. Mund të raportoj që Komisioni ka përgatitur një mision monitorimi ndërkombëtar, i gatshëm të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe ne e përpunuam këtë së bashku me Brukselin për ta bërë sa

më praktike dhe të zbatueshme, duke përfshirë po ashtu dhe financimin që nevojitet. Ka ekzistuar dëshira për t'i dhënë këtij misioni monitorimi ndërkombëtar një rol më të gjerë në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve shqiptarë në komisionet e vetting-ut dhe neni C, paragrafi 6 parashikon një mundësi të tillë dhe pasi ju të zgjidhni këto opsione, detajet duhet të reflektohen me qendrën në Bruksel, të cilët janë të gatshëm dhe janë duke e ndjekur këtë draft me vëmendje, veçanërisht pjesën e vetting-ut.

Ne u përpoqëm të jemi të drejtë dhe të hapur dhe kurdo që të marrim një alternativë konkrete nga opozita apo palët e tjera të interesuara politike, që natyrisht nuk duhet të shkelë parimin e ndarjes së pushteteve, në përputhje me Komisionin e Venecias. Shpresoj që të kemi kontribuar sado pak në unitetin kombëtar dhe vendimet tuaja për një draft përfundimtar. Jam shumë i sigurt se këto amendamente janë shumë më të mira sesa sistemi ekzistues dhe kjo do t'i shërbejë shtetasve shqiptarë duke shprehur përgjegjësinë për të ardhmen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky është një hap i madh për zbatimin e vlerave evropiane dhe shpresoj të gjeni arsyet e mjaftueshme për të vazhduar me këtë draft.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit z. Smibert dhe z. Deville!

Besoj se tani është momenti për të thënë se cilët do të jenë hapat e mëtejshëm lidhur me shqyrtimin e këtij dokumenti, por përpara se ta vazhdoj këtë procedurë, më duhet të jap vlerësimet më të mira për të dy ekspertët ndërkombëtarë, zotin Deville dhe zotin Smibert të cilët kanë dhe meritojnë vlerësimin tonë maksimal për angazhimin e tyre të jashtëzakonshëm në këtë proces, për neutralitetin dhe frymën konstruktive me të cilën kanë bashkëpunuar me ekspertët vendas. Një meritë të lartë ka Sekretariati Teknik, përfaqësuesit e opozitës etj.

Gjithsesi, sot kemi një produkt të paraqitur prej tyre, mbështetur edhe në detyrën e dhënë nga ana jonë. Besoj se ishin të qarta shpjegimet e dhëna prej tyre. Natyrisht, duhet që kolegët të njihen më në detaje me dokumentin dhe më pas, do t'ia nënshtrojmë procesit të mëtejshëm.

Për efekt procedural dua të jem korrekt. Kemi një propozim të kolegut Majko, i cili ka propozuar ta votojmë sot në parim këtë dokument. Ky është një propozim i arsyeshëm, duke pasur parasysh se nuk është një dokument i panjohur për ne, ashtu siç është edhe opinionin final i Komisionit të Venecias, edhe fakti që kemi debatuar ndërmjet

nesh për një sërë çështjesh, ashtu siç është e arsyeshme edhe ideja që duhet koha e mjaftueshme për t'u njohur me këtë dokument, për të bërë pyetje, për të diskutuar, dhe më pas, për ta votuar.

Një gjë po e them që tani. Sido që të vendosim sot, java që vjen është një javë intensive pune. Kjo do të thotë që nuk do të ngrihemi kollaj nga kjo tryezë pa konkluduar, do të thotë që duhet të kemi angazhimin maksimal për ta çuar para procesin pa ndërprerje. Axhenda është fare e thjeshtë. Do të fokusohemi te projekti, te votimi në parim, votimin nen për nen dhe në tërësi. Më pas do të fillojmë menjëherë me 5-6 projektligjet kuadër, që do ta bëjnë të implementueshëm projektin kushtetues, në mënyrë që paketa të shkojë e plotë deri në fund të majit në Kuvend për t'iu nënshtruar më pas gjykimit në seancë plenare.

Në rregull. Pra, kemi propozimin procedural të zotit Majko. A keni ndonjë koment?

Urdhëroni, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Them se është racionale, siç e thashë edhe në fillim, që unë dhe kolegët të njihemi me draftin e rishkruar me ngjyrat e zeza, të kuqe dhe blu. Unë i hodha një sy, ndërsa po dëgjoja ekspertët. Sigurisht, ekspertët janë të njohur, sepse ata kanë qenë edhe pjesë e përgatitjes së draftit të parë të shtatorit, edhe të draftit të dytë të 15 janarit 2016.

Qëndrimi i ekspertëve të opozitës dhe yni, siç është bërë i ditur, ka qenë i bazuar vetëm në standardet e Komisionit të Venecias. Venecia ka dhënë opinionin e vet që kemi sjellë këtë draft, i cili sipas ekspertëve, ka implementuar opinionin e Komisionit të Venecias dhe të gjitha shqetësimet e ngritura gjatë këtij komisioni. Për këtë arsye, unë gjykoj që është racionale, që ta përcaktojmë që sot, që deri ditën e hënë në mesditë apo në mëngjes, ekspertët tanë ta marrin të gjithë materialin. Na e dërgoni me *e-mail* materialin edhe neve, që të kemi mundësi ta punojmë me ekspertët tanë, ta analizojmë dhe të hënën, meqë kjo është më e rëndësishme se mbledhja e Komisionit të Ligjeve. Mund ta bëjmë mbledhjen në Komisionin e Ligjeve. Të vazhdojmë me pyetjet, diskutimet dhe më pas të vijojmë me procedurën normale. Mendoj se kjo është racionale, sepse nuk besoj se ka njeri në këtë tryezë, që është në gjendje sot të bëjë pyetje mbi të gjitha këto implementime. Ajo që është më e rëndësishme e theksoj edhe një herë dhe do ta them më

pas edhe para mediave, se ne jemi dakord në parim me pjesën e komponentit antikorrupsion, që përfshin të gjithë procesin që përmendi zoti Deville për të gjithë *vetting-un* e gjyqtarëve dhe prokurorëve, që sigurisht, është impakti i parë konkret që do të japë për reformën në drejtësi, për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas rekomandimit të Komisionit të Venecias. Do ta shohim edhe pjesën e implementimit. Më pas, sigurisht do të procedojmë të hënën me këtë draft. Nuk besoj se ka rast për ndonjë debat. Nuk ka diskutim që duhen ndryshime. Duhet të ketë një draft kushtetues, i cili do të përbëjë hapin e parë të reformës në drejtësi. Për këtë nuk ka pasur kurrë diskutim. I vetmi diskutim që na ka ndarë deri sot, ka qenë që drafti i ndryshimeve kushtetuese duhet të ishte në përputhje me Komisionin e Venecias dhe të arrihej me konsensusin e të dyja palëve. Do ta shohim këtë. Kaq. Ky është parimi. Kur të vijë nen për nen më pas, nuk ka të bëjë, nëse është implementuar apo nuk është implementuar në këtë nen apo në atë nen. Kjo do të diskutohet edhe me ekspertët. Unë mendoj që kjo është racionale

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Halimi!

Urdhëroni, zoti Majko!

Ai ka kërkuar të reagojë, meqë ishte propozues i këtij aspekti procedural. Më pas, e ka fjalën zoti Vasili.

Pandeli Majko – Unë po përpiqem të jem sa më i qartë, nisur nga një përvojë modeste si deputet. Votimi në parim, nuk vendos asnjë detyrim apo angazhim për asnjë deputet për të mos diskutuar nen për nen për të gjitha problematikat që kanë ngritur qoftë ekspertët ndërkombëtarë, qoftë për atë që ka opinione të ndryshme nga ato që janë shprehur në draft, që e përsëris: është drafti i bazuar mbi opinionin e Komisionit të Venecias dhe asaj që kemi diskutuar ne deri më sot në komision.

Unë mendoj se votimi në parim është thjesht shprehje e vullnetit për angazhimin karshi diskutimit të këtij drafti që vijon më pas, me diskutimin nen për nen. Po e them edhe një herë, se votimi në parim, nuk ndalon asnjë deputet për të hedhur opsionet e veta, por gjithsesi, ai përbën një fillim shumë të mbarë dhe një lajm shumë të mirë për të gjithë ata, qofshin të vendit apo për ata që na ndjekin nga kancelaritë përkatëse.

Mendoj se është momenti që ne ta votojmë. Megjithatë jam i hapur të dëgjoj me vëmendje të gjithë mendimet e kolegëve, sepse këtu jemi për t'i marrë vendimet me konsensus. Dua të përsëris se kjo tendencë për të thënë: do të mendohemi dhe do ta

rishikojmë, sikur drafti është diçka që sapo ka ardhur për herë të parë dhe ka trokitur në dyert e komisionit, nuk më duket shumë luajale.

Drafti është bazuar mbi opinion e Komisionit të Venecias dhe në atë që kemi diskutuar këtu. Gjatë shqyrtimit nen për nen secili nga ne më pas është i lirë ta diskutojë. Votimi në parim nuk përfshin asgjë të gabuar qoftë politikisht, qoftë publikisht dhe kështu me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Ju lutem!

E para të dëgjojmë njëri-tjetrin, të ezaurojmë të gjithë këtë debat. Zoti Vasili e kërkoi fjalën pas zotit Majko. Pastaj e kanë fjalën zoti Halimi dhe zoti Mediu.

Petrit Vasili - Faleminderit!

Mendoj që sot jemi në një moment të ecjes përpara, të vënies në lëvizje të gjithë procesit, është shumë i rëndësishëm pasi sot kemi një opinion, i cili absolutisht është objektiv, thellësisht profesional, por besoj se edhe për paanshmërinë e tij të gjithë në këtë tavolinë jemi shumë të qartë, sepse pas opinionit të Venecias dy ekspertët që përfaqësojnë dy partnerët tanë më të rëndësishëm, BE-në dhe SHBA-të, kanë formuluar një draft, të cilin ne e besojmë pasi bazohet në standardet ndërkombëtare dhe në ekspertizën ndërkombëtare më të kualifikuar, që mund të kishim në dispozicion, por gjithashtu dhe në atë që ka qenë problemi ynë i vazhdueshëm i mosbesimit reciprok. Prania dhe roli shumë aktiv qoftë i ekspertëve të EURALIUS-it, qoftë të OPDAT-it është një qetësim për të gjithë ne. E thënë e gjitha kjo, mendoj se ne kemi arsye shumë më të forta sot, shumë më të forta se një muaj, se tre muaj dhe një vit më parë që ne bashkohemi në parim se kemi draftin e duhur për të votuar dhe ashtu siç sugjerojnë ekspertët në momente të caktuara kemi mundësi që në debatin nen për nen të konsumojmë alternativa, pse jo dhe debat. Por besoj se të gjithë bashkë kemi një detyrim të madh mbi shpinë që të dalim sot së paku dhe të gjithë shqiptarët që na ndjekin në mënyrë indirekte, sepse rezultatet e këtij takimi do të bëhen publike dhe kjo është fare e qartë, të marrin mesazhin e qartë të një ndjeshmërie të re për reformën në drejtësi dhe të një hapi që konkretisht u hodh. Hapi parimor për t'i thënë po reformës, duke pasur një dakordësi në parim. Javët që kemi përpara na mundësojnë të shtjellojmë dhe më shumë.

Mund të ketë kolegë, të cilët me të drejtë mund të kenë rezervë në teknikalitetet e caktuara, në kohën dhe mundësitë, por mendoj se qëndrimi në parim dhe mesazhi që japim në parim është vetëm pozitiv. Unë personalisht nuk shikoj asnjë arsye pse të hezitohet. Besoj se nuk na i shter mundësitë për të diskutuar dhe as nuk na pamundëson diskutimin, por na hap mundësinë që duke u bazuar në një dakordësi parimore të kemi mundësi që në javët që vijnë, vërtet të arrijmë axhendën me shpejtësi. Mendoj dhe ndaj të njëjtin mendim me bashkëkryetarin zotin Xhafaj që çdo ditë e humbur është ditë e humbur në ditët që presin miratimin, sepse duhet të jemi të shpejtë në këtë gjë, pasi të gjithë e dimë se kemi një punë shumë të madhe me ligjet që do të pasojnë pas këtyre ndryshimeve kushtetuese, të cilat kërkojnë mjaft kohë. Me thënë të drejtën, në mënyrë metaforike, armikun më të madh kemi kohën, në këtë moment. Kohën e humbur duhet ta kthejmë përfundimisht në një kohë të fituar. Në parim jam i mendimit që do të ishte shumë pozitive të jepnim jo thjesht dhe vetëm një mesazh, por një kuptim të ri se reforma në drejtësi hyri përfundimisht në rrugën e zgjidhjes. Ka dalë nga rruga e debatit shterpë, nga ajo e mosbesimit. Po ecim në një rrugë besimi reciprok, i cili formësohet dhe në ndryshimet përkatëse që mund të kemi në elemente të caktuara, të cilat mund të marrin debat dhe në diskutimin nen për nen.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Vasili!

Besoj se ishte e qartë që zoti Vasili ishte pro propozimit të zotit Majko për ta votuar sot në parim.

Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu - Faleminderit, zoti Xhafaj!

Unë dua të falënderoj ambasadorin Vlahutin dhe ambasadorin Lu për mbështetjen që i kanë dhënë reformës dhe komisionit në mënyrë të veçantë për të arritur gjuhën e konsensusit dhe gjithashtu përfaqësuesin e OPDAT-it dhe të EURALIUS-it që kanë qenë pjesë e këtij komisioni, sidomos për draftin përfundimtar që kanë sjellë pranë nesh.

Mendoj që diskutimi në parim apo miratimi në parim nuk ka ndonjë vlerë të madhe për faktin se kemi rënë dakord të gjithë në parim për këtë reformë të rëndësishme, si të shprehemi sot apo të hënën, në fund të fundit ne kemi rënë dakord për atë që duam

të analizojmë dhe të realizojmë të gjithë së bashku. Ne si opozitë kemi ngritur disa pyetje dhe disa shqetësime që shpresoj dhe besoj se e kanë gjetur përgjigjen te ky draft.

Ajo që kërkon zoti Halimi është që ne si parlamentarë të përgjegjshëm, brenda të gjithë funksionimit normal parlamentar që kemi për çdo ligj, për çdo reformë kushtetuese, edhe kur shprehemi në parim, kemi realisht leximin e draftit. Nëse nuk e kemi këtë lexim drafti paraprakisht, unë e kuptoj vullnetin e mirë të zotit Majko, të gjithë e kemi atë vullnet, por le ta lexojmë. Të arrijmë në një gjykim të përbashkët, ta miratojmë në parim dhe të shkojmë nen për nen për ta miratuar përfundimisht.

Ajo që është më e rëndësishme sesa të diskutojmë sot në parim, është që ne të përcaktojmë një axhendë konkrete të veprimit tonë për ta miratuar këtë reformë në afatin e duhur, në mënyrë që të kemi të gjitha ato benefite që tha ambasadori. Mund të diskutojmë në parim dhe mund të mos funksionojë nen për nen. T'i futemi thelbit, ta analizojmë sa më shpejt dhe të dalin përfundimet që duhen, ta miratojmë dhe të kemi atë proces që është kaq i rëndësishëm, të miratuar dhe të kemi mbështetjen si të faktorit ndërkombëtar dhe të opinionit vendas për atë që kemi bërë.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Mediu!

Eduard Halimi – Të jemi pak më pragmatistë dhe të sinqertë. Që të miratohet në parim, duhet të diskutohet në parim apo nuk është kështu? Kjo është procedurë, para se të miratohet në parim, bëhen pyetje në parim. Pastaj diskutohet në parim. Mbarojnë diskutimet në parim dhe miratohet në parim. Është kështu procedura apo jo? Nuk besoj se e ndihmon procesin, siç nuk kam besuar kurrë se: “Ne e duam reformën, këta nuk e duan atë; ne i duam ekspertët, këta nuk i duan ata; kush është kundër draftit, është kundër reformës dhe kundër shqiptarëve...”.

E dini pse? Sepse ne i kemi bërë këto ushtrime gjatë gjithë këtyre viteve. Gjykatat administrative, e kishte bërë USAID-i, e kishin bërë Shtetet e Bashkuara. Dilnit ju dhe nuk e miratonit. Ishit kundër ekspertëve. Ne dilnim dhe thoshim: “Ju nuk e doni këtë”. Këto janë ushtrime që nuk na ndihmojnë këtu ku jemi, në këtë proces. Le të jemi pragmatistë dhe racionalë në proces. Të jesh pragmatist dhe racional do të thotë të jesh eficient për procesin. Nuk sjell asnjë produkt, po them, deklarami: “Shiko, se u ra dakord në parim”, sepse do të bihet dakord në parim, kur të jetë rasti, pas diskutimeve në parim.

Në mënyrë racionale, duhet ta përmbyllim në këtë fazë. Nuk ka kuptim krijimi i ilaritetit, nëse ekspertët tanë janë kundër ekspertëve të EURALIUS, po them, apo kundër ekspertëve të OPDAT-it, sepse po të ishte ashtu, edhe ata, ekspertët e EURALIUS-it e të OPDAT-it bënë disa vërejtje në shtator, në tetor bënë ekspertët tanë disa vërejtje. U morën nga Venecia. Venecia e tha mendimin e vet. Tani s'po ia hyjmë ne të themi: kishin të drejtë ekspertët tanë apo ekspertët e tyre. Nuk na vlen kjo. Çështja është të ecim përpara.

Unë mendoj dhe gjykoj se, të ecim përpara do të thotë që të kalojmë fazën e duhur, sepse këtu nuk po diskutojmë një ligj të thjeshtë, por po diskutojmë ndryshimet kushtetuese. Të jemi të përgjegjshëm dhe racionale. Le ta lëmë larg këtë pjesën e retorikës, sepse nuk besoj se na ndihmon. Besoj se edhe kolegët e mi në të dyja anët, do të vazhdojnë me të njëjtën retorikë. Faza që duhet të kalojë është: pyetje në parim, diskutim në parim, miratim në parim. Pastaj: diskutim nen për nen i ndryshimeve kushtetuese, dhe atë qëndrim që kemi pasur përpara, që miratimi i ndryshimeve kushtetuese duhet të jetë bashkë me paketën, në mënyrë vertikale, të ligjit, për SPAK -un, për vetting-un. Gjatë miratimit, këto do të kenë edhe një kalendar të postuar. Ky është diskutim racional. Pra, do të kemi kalendar të postuar. Do të miratohen në grup, në komision, do të shkohet në parlament, e do të thuhet e më 10 qershor hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese, më 20 qershor hyri në fuqi ligji për SPAK-un, më 30 qershor hyn ligji për vettingun, më kaq gusht hyn ky ligj etj. Pra, miratohen në një ditë. Por ky është një diskutim që e kemi për më pas. Pjesa tjetër nuk na ndihmon, them unë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Më ngacmoi ndërhyrja e kolegut Majko, në lidhje me këtë propozim për miratim në parim. Unë nuk besoj se ne, sot kemi nevojë të bëjmë votim në parim, nëse na duhet reforma në drejtësi.

Fatmir Xhafaj – S'e ka për reformën, e ka për projektin.

Oerd Bylykbashi – Po në qoftë se sot votojmë në parim, pa lexuar gjë, por vetëm footnote-n e parë, do të thotë se po votojmë në parim për reformën në drejtësi. Unë besoj se kjo është çështja që na shtrohet neve sot.

Ekspierenca ime si parlamentar është e vogël. Para një viti, para pesë vjetësh, para dhjetë vjetësh, unë kam lexuar diskutimet tuaja, zoti Majko, edhe në komisionin e

Kushtetutës. Kështu do të kujtohen edhe këto që flasim ne. Do të lexohen nga të tjerët, e për rrjedhojë, ajo që ne themi këtu do të ketë një peshë të madhe.

Ju e dini shumë mirë se edhe presja në një Kushtetutë, vlen arsyetime në Gjykatën Kushtetuese. Kështu që nuk është historia nëse, te *track change* kemi shtesa apo jo, në një draft më të vjetër apo ky është drafti i ri. Mund të jemi përpara ndryshimesh thelbësore të asaj çfarë kemi parë. Unë nuk kam parë ende asgjë. Kam lexuar një shënim dhe u kam hedhur sytë disa pikave. Të mendoj se me atë votë, me të cilën, në fund të fundit kam ardhur këtu, ashtu si dhe të gjithë ju, jam i investuar që ta ngre dorën tani, në parim, pa lexuar, mundet që të jem duke tradhtuar atë votën atje, që ma kanë dhënë në parim, për të ardhur e për t'i përfaqësuar këtu.

Kësisoj, besoj se sugjerimi i kolegut Halimi është më se racional. Unë nuk shoh ndonjë nxitim më shumë se sa dita e hënë, që ta lexojmë, të ngremë ato pikëpyetjet tona në kokë, të bëjmë pyetjet në parim, diskutimin në parim, e më pas t'i hyjmë diskutimit nen për nen, sepse kjo është edhe Rregullorja e Parlamentit. Pavarësisht se po flasim për ndryshime kushtetuese, ky komision zbaton rregulloren e parlamentit, që Kushtetuta e përcakton si të detyrueshme për miratimin e akteve nga parlamenti.

E thashë se, kur ta ngremë dorën në seancë, jo vetëm në këtë komision, ne jemi shumë pak këtu, që të marrim përsipër barrën e një ndryshimi kaq të madh, por të paktën këtu, por edhe në seancë, ta bëjmë me sensin e krenarisë për atë që kemi bërë atëherë, ne së bashku, dhe për atë që do t'u lëmë shqiptarëve pas dhjetë, pesëmbëdhjetë, njëzet, dyzet vjetësh nga sot. në mënyrë që, pas dhjetë vjetësh, zoti Majko, të mos kthehemi ne të dy bashkë dhe të vazhdojmë ta diskutojmë përsëri nevojën për ndryshime themelore kushtetuese për reformën në drejtësi.

Kështu që, unë besoj se është shumë e rëndësishme të bindemi, të diskutojmë, të bëjmë edhe ndryshime, nëse është e nevojshme, e më pas t'u drejtohem votimit. Siç e thatë, zoti kryetar, besoj se është racionale që të marrim pak kohë. Kolegu Halimi propozoi ditën e hënë. Them të mos e zgjasim më tej.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi, do të kem mirëkuptimin tuaj, se një zonjë tjetër gjithashtu shumë e nderuar, ka kërkuar fjalën. Po, zonja Vlahutin ka kërkuar fjalën, për një ndërhyrje.

Romana Vlahutin – Thjesht dua të nënvizoj diçka në lidhje me atë çfarë tha z. Vasili. Fatkeqësisht, jemi në garë me kohën. Situata është e tillë që për arsye të ndryshme, një *momentum* është krijuar për Shqipërinë. Nëse kjo reformë miratohet, Shqipëria do të marrë një opinion të favorshëm në nëntor. Ky *momentum* është krijuar për në vjeshtë të këtij viti edhe për disa arsye të tjera. Vitin e ardhshëm ka zgjedhje në disa shtete anëtare kyçe të Evropës. Nëse e humbisni këtë vit, shumëzoheni atë me të paktën katër. Kjo është diçka të cilën sigurisht nuk mund ta përballoni dhe as ne nuk duam ta përballojmë. Kur shikojmë rajonin, Shqipëria ka një rol të rëndësishëm stabilizues. Ky është një partneritet. Ju lutem, na ndihmoni që t’ju ndihmojmë. Për fat të keq, jemi në garë me kohën. Kjo duhet të përfundojë para pushimeve të verës. Duhet të fillojmë zbatimin, maksimumi në 1 tetor. Nga ana jonë, ne kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe planifikimet, sidomos për misionin ndërkombëtar monitorues. Duhet të kemi disa rekorde për zbatimin në mënyrë që të vijojmë. Unë nuk kam nevojë për t’ju shpjeguar se çfarë ndryshimi të madh ka për Shqipërinë në qoftë se ajo është duke negociuar anëtarësimin apo jo. Unë mendoj se ju e kuptoni plotësisht atë, kështu që nëse ju votoni sot apo jo, ju lutem të kenë afate shumë të qarta në mendjen tuaj. Kjo nuk mund të shtyhet më shumë. Shumë çështje këtu janë diskutuar në gjerësi për shumë kohë. Ne besojmë se kanë ngelur shumë pak gjëra që duhet të përcaktohen dhe unë jam e sigurt se jemi afër këtyre përkufizime. Ne nuk mund të lejojmë vazhdimin e shtyrjeve të vendimeve. Ju duhet të hidheni dhe të notoni. Janë bërë mjaftueshëm përgatitje. Ju lutemi të kini parasysh se ne kemi nevojë për angazhimin tuaj për planifikim të qartë, pasi ky është një operacion i madh. Kjo është reforma më e madhe që Shqipëria do të bëjë. Kjo është gjithashtu një reformë që do t’ju kursejë disa vite kohë në negociata. Do bëni diçka që dy vendet të cilat po negociojnë nuk e kanë bërë ende. Pra, kjo është një mundësi shumë e rëndësishme. Rruga është shumë e qartë por nuk mund ta bëjmë pa ju. Kjo është e gjitha për të cilën unë jam duke u lutur, për drejtime të qarta, angazhim të qartë. Jo më shumë shtyrje të datave të takimeve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Donald Lu – Jam i gatshëm të marr një angazhim për z. Majkon. Nëse z. Majko mund të presë për këtë votim deri të hënën, unë, si qeveritar i SHBA-s marr përsipër të publikoj një deklaratë të hënën me listën e emrave të atyre që votojnë kundër në parim,

sepse mendoj se njerëzit duhet të mbajnë përgjegjësi. Mënyra më e mirë nuk është për të pasur vota të ndara sot por mënyra më e mirë është për të pasur një votim të unifikuar të hënën. Por nëse votojnë kundër të hënën, mendoj se duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Nëse ju nuk keni plan të ecni përpara, atëherë është e pamundur për të përfunduar para mbarimit të sesionit parlamentar.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Në fakt, po t'u referohemi rregullave të funksionimit të komisioneve parlamentare, diskutimi në parim i një projektligji, qofshin këto edhe ndryshime kushtetuese, ka tri faza: prezantimi i nismës, pyetje dhe diskutime. Duke dëgjuar kolegët e opozitës, shumë shpejt rendita nëse i kemi kaluar këtu në komision pikërisht këto tri faza, pra fazën e parë të prezantimit të ndryshimeve të projektit, pyetjet rreth tij dhe diskutimet. Në fakt, ne jemi mbledhur plot 7 herë, nga të cilat 4 kanë qenë prezantime.

E para, ka qenë prezantimi i nismës ku kolegët, ekspertët vendas dhe të huaj kanë paraqitur nismën dhe ne kemi bërë shumë pyetje.

E dyta, jemi njohur në komision me opinionet me shkrim që kanë paraqitur përfaqësuesit e forcave politike në parlament, në komision.

E treta, kemi pasur mundësinë të bëjmë pyetje dhe diskutime kur ka ardhur raporti paraprak i Komisionit të Venecias.

E katërta, kemi pasur mundësi të bëjmë pyetje dhe diskutime, madje t'u drejtohem ekspertëve vendas dhe të huaj përsëri këtu në komision pas ardhjes së raportit të ndërmjetëm.

E pesta, kemi marrë një dokument me 10 çështje të diskutueshme të paraqitura nga kolegët e opozitës, të cilave u kemi kushtuar plot 2 mbledhje, ku kemi bërë shumë pyetje, kemi diskutuar, madje kemi lënë shumë detyra për ekspertët vendas dhe të huaj. Përsëri, pas ardhjes së raportit final të Komisionit të Venecias, si edhe për pyetjet që patën kolegët e opozitës ne kemi lënë detyrë më shkrim 50 pyetje, për të cilat kemi marrë 54 përgjigje me shkrim. Nga leximi i këtij dokumenti paraprak shikoj sot se, me të drejtë, në bazë edhe të përvojës sime 7-vjeçare, është dokumenti parlamentar më i plotë, më transparent që mbart të gjitha lidhjet ndërmjet projektit paraprak, lidhjet me paragrafë të veçantë të raportit të Komisionit të Venecias, si edhe lidhjet me pyetjet që kanë shtruar

kolegët këtu në komision, kryesisht ata të opozitës, por edhe të maxhorancës. Sikur t'i bënim të gjitha dokumentet parlamentare, të dashur kolegë, në një formë të tillë, ku bëhet qartë ecuria e një projektligji, pra si ka qenë drafti paraprak, si ka ndryshuar, si janë reflektuar ndryshimet, ku ka përputhje me një dokument direktiv apo me një raport, siç është rasti i Komisionit të Venecias, ne do të ishim shumë më mirë se jemi sot në të gjitha diskutimet e projektligjeve që kemi bërë në parlament. Ndaj, do t'ju lutem, të më lini t'ju falënderoj sinqerisht për prodhimin e një modeli, të cilin ne mund ta përdorim edhe si dokument, edhe si model praktik pune për ligjet e tjera.

Nga ana tjetër, ju, të nderuar kolegë, thatë se duhet të ecim. Kjo do të thotë të ecim. Unë, personalisht, do të ndihesha keq kur të lija sot mjediset e këtij parlamenti, se jashtë pa dyshim pret media dhe, kur t'ju pyesin gazetarët se çfarë u vendos, të thoni: duam ca kohë për të studiuar materialin. Mua më duket sikur po na bëni sikur ne në këto mbledhje kemi fjetur gjithë kohës, sikur nuk kemi dëgjuar, sikur nuk kemi diskutuar dhe sikur nuk janë reflektuar ndryshimet. Po të shikoni, pjesa më e madhe e këtyre me të kuqe janë *footnote* dhe të gjitha ato shqetësime, që kanë gjetur zgjidhje në dokumentin që paraqitën dy ekspertët ndërkombëtarë në mbledhjen e kaluar janë bërë bazuar në pyetjet tona. Meqë ju thoni se kjo është Kushtetutë, po, është Kushtetutë, por, zoti Bylykbashi, ndjesë që po të përmend me emër, po sikur të ishim marrë me projektligjin për ndryshimet kushtetuese në kuadër të pastërtisë së figurave kaq shumë, kaq gjatë dhe me kaq diskutime dhe me konsultim, sinqerisht unë do të isha e para që do ta mbështesja ambasadorin amerikan dhe do t'i thosha: po, ditën e hënë ne duhet ta miratojmë, sepse nuk kemi pasur mundësi. Por që nga 14 nëntori, kur është ngritur komisioni, pra në dhjetor të vitit 2014, janë 16 muaj. Taksapaguesit do të vazhdojnë të paguajnë mbledhjet tona sa herë që ne do të themi: "Na duhet kohë"?

Unë nuk e pranoj se nuk kam pasur kohën e mjaftueshme për t'i lexuar, për t'i parë dhe për t'i reflektuar, sepse kemi diskutuar disa herë në parim. Kemi bërë shumë pyetje, kemi pyetur ekspertët vendas e të huaj; kemi edhe dokumente. Prandaj, është më mirë ta miratojmë sot në parim dhe ditën e hënë të vazhdojmë nen për nen, ashtu sikurse veprojmë në komision.

Për ta mbyllur, ne të gjithë jemi anëtarë të Komisionit të Ligjeve. Në komision, ne diskutojmë ligjin në parim. Ju jeni dëshmitarë që, si relatorë, ne kemi bërë shumë

ndryshime, madje mund të kemi pasur edhe kontestime për nene të veçanta, pavarësisht se kemi votuar në parim, por askush nuk na e ka hequr të drejtën të diskutojmë detaj më detaj çdo paragraf.

Për ne mjafton e shtuna dhe e diela, meqenëse nesër ka aktivitete; ka parlament, ka komisione, që ne të punojmë, por të paktën të përcjellim mesazhin se ne nuk i hamë lekët e taksapaguesve kot, për të bërë *show*. Ndjesë që po të drejtohem, sepse edhe të përmenda, por për faktin se kemi përvojë edhe te Komisioni i Dekriminalizimit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëro!

Oerd Bylykbashi – Me gjithë respektin që kam për ju si kolege, por, mbi të gjitha, duke qenë se ju njoh shumë më herët, unë nuk kam hyrë kurrë në provim pa lexuar tekstin. Pra, kjo ishte e para.

E dyta, unë nuk e kam lexuar dhe nuk e kam idenë fare. Ndoshta kur ta lexoj mund të jem dakord më shumë se ju, por pasi ta lexoj do të jap opinionin tim. Do të bëj pyetje, do të diskutoj e të tjera, por unë nuk e kam lexuar. Nuk e di se kur e keni lexuar ju. Nuk besoj se e keni lexuar.

Nga ana tjetër, referoheni gabim në lidhje me atë procesin tjetër, sepse vetë ju jeni shprehur shumë e entuziazmuar për të gjithë projektligjin dhe për projektin e ndryshimeve kushtetuese, kur u votuan. Pra, nuk di cilën të marr nga të dyja.

Unë, me aq pak sa lexova në fillim, kuptova që te neni 3 na bie të ndryshojmë ligjin “Për dekriminalizimin”, pasi e kemi miratuar, pra vetëm me një togfjalësh të shtuar. Por kjo nuk mjafton që unë të nxjerr konkluzion dhe të them: e mbylla me kaq.

Kështu që, siç tha edhe zoti ambasador, ndoshta është më mirë të arrijmë në konkluzione të unifikuara; të mos e shtyjmë njëri-tjetrin te kjo gjë, sepse në këtë mënyrë ju nuk tregoni se jeni më shumë pro reformës në drejtësi sesa jemi ne. Unë besoj se kjo reformë në drejtësi, nga gjërat e para që do të bëjë, është se do të çojë ministra në burg. Kështu që të mos e ekzagjerojmë me populizma këtë bisedë, por t’i biem një hullie shumë stabël e shumë të qetë.

Zoti Halimi propozoi një gjë shumë të thjeshtë, që ditën e hënë të mblidhemi dhe të ecim përpara.

Fatmir Xhafaj – Ne jemi të interesuar të kemi një votë të përbashkët. Jam dakord me kolegët se do të ishte një lajm shumë pozitiv për qytetarët e këtij vendi nëse sot do të bënim një votim në parim, por edhe logjika tjetër është e respektuar. Për sa kohë që të gjithë bashkë duam të japim mesazhin për ta mbështetur këtë projekt, atëherë jemi dakord që ditën e hënë, në orën 12:00, në këtë sallë të kemi seancë pyetjesh, diskutimesh dhe votim në parim. Pra,...

Romana Vlahutin – A mund të fillojmë pak më herët, sepse është Dita e Europës?

Fatmir Xhafaj – Dakord, ora 10:00 besoj është e përshtatshme.

Eduard Halimi – Kam vetëm diçka. Ndërmjet orës 10 dhe 12 ka një mbledhje grupi parlamentar, ku do të prezantohet platforma për ...

Fatmir Xhafaj – E lëmë në orën 09:00, atëherë.

Eduard Halimi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Pra, në orën 09:00 të mëngjesit, meqenëse është edhe Dita e Europës. A ka lajm më të mirë për Europën?

Pra, ditën e hënë në orën 09:00 do të jemi në këtë sallë për të diskutuar, për të bërë pyetje, diskutime në parim, si dhe votim në parim për projektin kushtetues. Të hënë do t'ju lutesha ta përcillni draftin në mënyrë elektronike dhe do të vazhdojmë me kalendarin në vazhdim.

Ndërkohë, ditën e hënë do të përcaktojmë edhe kalendarin se si do të vazhdojmë në ditët në vijim për të gjithë javën, për projektin kushtetues dhe pastaj për ligjet kuadër, që do të shoqërojnë projektin kushtetues. Besoj se nuk ishte tamam ajo që do të donim të kishim sot, gjithsesi është diçka shumë e mirë dhe një hap pozitiv edhe kjo që kemi arritur. Së paku, kemi vendosur në parim që do të votojmë të hënë në parim për projektin kushtetues.

Faleminderit të gjithë kolegëve!

Faleminderit, zonja Ambasadore!

Faleminderit, zoti Ambasador!

Faleminderit, zoti Smibert!

Faleminderit, zoti Deville!

Faleminderit ekipit të përkthimit dhe të gjithë ekipit mbështetës për këtë proces!

Faleminderit të gjithëve!

MBLEDHJA MBYLLET

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal.
Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin*